




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



KOMISIONI KOMUNAL PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE KUNDËR AKTVENDIMIT TË
INSPEKTORIT NË NIVEL LOKAL

Lënda:
DT.10.11.2022

14-580/02-0131829/22

Komisioni Komunal Për Shqyrtimin e Ankesave Kundër Aktvendimit të Inspektorit në nivel lokal, në përbërje: Bahrije Mahmuti-Beqiri, kryetare, Sevdije Maliqi-Hyseni, anëtare, Fehmi Agushi, anëtar dhe Salih Fazliu, anëtar (*Vendimi i Kryetarit të Komunës 02.Nr.895 i datës 19.08.2022*), duke shqyrtuar ankesën e palës Sabedin Sefedini përmes përfaqësuesit av.Ymer Huruglica, kundër Aktvendimit për Rrënim nr.14-02/04-945/03-0127576/22-70 datës 01.11.2022 të lëshuar nga Inspektori ndërtimor komunal, bazuar në nenin 17, nenin 22 pika 1.11, nenin 45 të Ligjit nr.04/L-175 dhe nenin 5 pika 1.1 UA MMPH nr.20/2013, me datë 30.08.2022, merr këtë :

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar ankesa e palës Sabedin Sefedini kundër Aktvendimit për Rrënim nr.14-02/04-945/03-0127576/22-70 datës 01.11.2022 të lëshuar nga Inspektori ndërtimor komunal.
2. **Mbetet në fuqi** Aktvendimi për Rrënim nr.14-02/04-945/03-0127576/22-70 datës 01.11.2022.

Arsyetim

Pala, Sabedin Sefedini nga Gjilani i pakënaqur me Aktvendimin për Rrënim nr.14-02/04-945/03-0127576/22-70 datës 01.11.2022 të lëshuar nga Inspektori ndërtimor komunal, i është drejtuar Komunës së Gjilanit me Ankesën nr. 14-580/02-0131829/22 me datë 10.11.2022. Në ankesën e tij me shkrim i njëjti pretendon se Inspeksioni komunal me këtë vendim ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesës së tij i ka bashkangjitur kopjen e ankesës drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë dhe kopjen e padisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë për çështje administrative –heshtje administrative dhe njëherit kërkon nga komisioni komunal për ankesa që ta aprovon ankesën si të bazuar, të anulon Aktvendimin e atakuar derisa të vendoset rreth ankesës dhe padisë së investitorit.

Me qëllim të zgjidhjes së drejtë të çështjes komisioni i shqyrtoi të gjitha provat e ofruara nga pala si dhe provat tjera sipas detyrës zyrtare si: procesverbalin mbi Inspektimin nr.14-02-0216 datës 08.07.2022 për ndërprerjen e punimeve të lëshuar nga Drejtoria e Inspeksionit; procesverbalin mbi Inspektimin nr.14-02-0235 datës 23.07.2022 për shiritim të objektit dhe shqiptimin e gjobës me nr.DI 14-02(003) si dhe disa foto nga vendi i ngjarjes dhe gjendjes së fazës ndërtimore të objektit.

Pas shqyrtimit të gjitha provave një nga një si dhe të gjitha provave në tërësi, Komisioni konstatoi se Inspektori Komunal Ndërtimor me rasti në ndërtim dhe inspektimi sepse investitori para fillimit të punimeve duhet të pajiset me leje ndërtimore gofite edhe për objekt montues ashtu siç parashihet me nenin 14, paragrafi 1, pikë 1.1 i Ligjit nr.04/L-110. Edhe vetë pala në ankesën e vetë ka pranuar faktin se objekti në ndërtim në kohën e inspektimit nuk ka qenë i pajisur me leje ndërtimore duke pretenduar se për objekte montuese nuk nevojitet leja ndërtimore. Nga kjo rrethanë Komisioni i Ankesave konstaton se Inspektori Komunal ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt dispozitat procedurale sepse para çdo ndërtimi pjesëmarrësit në ndërtim janë të obliguar të pajisen me leje ndërtimore. Komisioni gjatë vendosjes lidhur me këtë gëshje u bazua edhe në nenin 9 të Ligjit nr.04/L-10, paragrafi 2 ku thuhet se "Ushtrimi i mjetit juridik në vendimin e organit administrativ, ose hapja e konfliktit administrativ nuk e ndal ekzekutimin e vendimit, përveç nëse nuk vendos ndryshe organi kompetent".


Bazuar në të theksuarat si më lartë, Komisioni i Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike : pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese kundër tij në afat prej 30 ditëve pas pranimit të vendimit në MMPH.

- **Vendimi i dorëzohet :**
- **Pales,**
- **Drejtorisë së inspeksionit**
- **Kryetarit të Komunitës**

Gjilan, 15.12.2022

Komisioni Komunal për shqyrtimin e ankesave:

 **Bahrije Mahmuti – kryetare**

 **Sevdije Maligj-Hyseni, nëtare**

 **Fehmi Agushi, anëtar**

 **Salih Fazliu, anëtar**